

## I. KATEGORITË E LEJEDREJTIMIT, PËRKUFIZIMET DHE MOSHAT MINIMALE

Lejedrejtimit e lëshuara nga 24 Janari 2017:

Tab. 01

| Kategoria | Përkufizimi  | Mosha minimale |
|-----------|--|----------------|
| AM        | <ul style="list-style-type: none"> <li>Mjete me dy rrota (kategoria L1), projektuar me shpejtësi maksimale më të madhe se 25 km/orë dhe jo më shumë se 45 km/orë, cilindrata e të cilave është më e vogël ose e barabartë me 50 cm<sup>3</sup>, nëse është me djegie të brendshme, ose fuqia nominale e vazhduar e të cilit është më e vogël apo e barabartë me 4kw, për motorët elektrikë;</li> <li>Mjete me tri rrota (kategoria L2), projektuar me shpejtësi maksimale më të madhe se 25 km/orë dhe jo më shumë se 45 km/orë dhe me motor me cilindratë më të ulët ose të barabartë me 50 cm<sup>3</sup>, nëse është me ndezje të komanduar, ose fuqia maksimale e të cilit është më e ulët apo e barabartë me 4 kw, për motorët e tjerë me djegie të brendshme, ose fuqia nominale e vazhduar e të cilit është më e vogël ose e barabartë me 4 kw, për motorët elektrikë;</li> <li>Mjete me katër rrota të lehta (kategoria L6), masa bosh e të cilave është më e ulët ose e barabartë me 350 kg, duke përfshirë masën e baterive për mjetet elektrike, projektuar me shpejtësi maksimale më të madhe se 25 km/orë dhe jo më shumë se 45 km/orë, me cilindratë të motorit më të ulët ose të barabartë me 50 cm<sup>3</sup>, për motorët me ndezje të komanduar, ose fuqia maksimale e të cilit është më e ulët apo e barabartë me 4 kw, për motorët e tjerë me djegie të brendshme, ose fuqia nominale e vazhduar e të cilit është më e vogël ose e barabartë me 4 kw, për motorët elektrikë.</li> </ul> | 16 vjeç        |
| A1        | <ul style="list-style-type: none"> <li>Motorë pa kosh (kategoria L3), me cilindratë deri 125 cm<sup>3</sup> dhe fuqi maksimale deri 11 kw, me raport fuqi/peshë jo më shumë se 0.1kw/kg;</li> <li>Motorë me kosh (kategoria L4), me cilindratë deri 125 cm<sup>3</sup> dhe fuqi maksimale deri 11 kw, me raport fuqi/peshë jo më shumë se 0.1kw/kg;</li> <li>Tricikël [motomjete me tri rrota, simetrike ndaj aksit gjatësor (kategoria L5)], me fuqi deri 15kw;</li> <li>Makina bujqësore dhe kompleset e mjeteve bujqësore që nuk i kalojnë kufijtë e përcaktuar në nenin 53, pika 4 e Kodit Rrugor (gjerësia: 1.6 m, gjatësia: 4m, lartësia 2.5 m, masa maksimale e autorizuar me ngarkesë: 2.5 tonë, shpejtësia: 40 km/orë).</li> </ul>  | 18 vjeç        |
|           | <ul style="list-style-type: none"> <li>Motorë pa kosh (kategoria L3), me fuqi maksimale deri 35 kw dhe me raport fuqi/peshë jo më shumë se 0.2 kw/kg, që nuk rrjedh nga</li> </ul>   |                |

|    |   |   |
|----|---|---|
| A2 | <p>një mjet me më shumë se dyfishi i fuqisë së tij;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Motorë me kosh (kategoria L4) me fuqi maksimale deri 35 kw dhe me raport fuqi/peshë jo më shumë se 0.2 kw/kg, që nuk rrjedh nga një mjet me më shumë se dyfishi i fuqisë së tij.</li> </ul>  | 18 vjeç   |
| A  | <ul style="list-style-type: none"> <li>• Motomjete me fuqi më të madhe se 15 kw (motomjete me tri rrota, simetrike ndaj aksit gjatësor) dhe me kusht që të jenë mbi 21 vjeç;</li> <li>• Motorë pa kosh (kategori L3) ose me kosh (kategori L4) që nuk i përkasin kategorive A1 dhe A2;</li> </ul>   | 20 vjeç<br>Të paktën 2 vjet pas A2                              |
| B1 | <ul style="list-style-type: none"> <li>• Motomjete me katër rrota, të ndryshëm nga ata të kategorisë AM, masa pa ngarkesë e të cilave është më e vogël ose e barabartë me 400 kg ose 550 kg për mjetet e destinuara për transport mallrash (kategoria L7), përjashtuar masën e baterive për mjetet elektrikë, të cilat fuqinë maksimale neto të motorit e kanë më të ulët ose të barabartë me 15kw;</li> <li>• Mjete të tjera që konsiderohen motomjete me tri rrota simetrike ndaj aksit gjatësor (kategoria L5).</li> </ul>   | 18 vjeç   |
| B  | <ul style="list-style-type: none"> <li>• Automjete me masë maksimale të autorizuar jo më të madhe se 3500 kg dhe me jo më shumë se 8 ndenjëse, përjashtuar ndenjësen e drejtuesit të mjetit. Mjetet e kësaj kategorie mund të tërheqin një rimorkio të lehtë ose një gjysmërimorkio që nuk e kalon masën maksimale të autorizuar 750 kg;</li> <li>• Motomjete me tri rrota simetrike ndaj aksit gjatësor me fuqi më të madhe se 15 kw (e vlefshme vetëm për territorin kombëtar);</li> <li>• Motomjete të kategorisë A1 me kusht që mbajtësi i lejedrejtimit të jetë të paktën 21 vjeç (e vlefshme vetëm për territorin kombëtar);</li> <li>• Makinat bujqësore;</li> <li>• Makinat teknologjike;</li> </ul> <p>Kategoria B me kodin 96: - kombinimi i një mjeti të kategorisë B dhe një rimorkio ose gjysmërimorkioje që i kalon 750 kg, kur masa maksimale e autorizuar e një kombinimi të tillë është më i vogël se 4250 kg.</p> | 18 vjeç<br><br>Kategoria B me kodin 96, të paktën një vit pas B |
| BE | <ul style="list-style-type: none"> <li>• Kombinimi i një mjeti të kategorisë B dhe një rimorkio ose gjysmërimorkioje, ku masa maksimale e autorizuar e rimorkios ose gjysmërimorkios nuk i kalon 3500 kg.</li> </ul>  | 19 vjeç<br><br>Të paktën një vit pas B                          |

|     |  |  |
|-----|--|--|
| C1  | <ul style="list-style-type: none"> <li>• Automjete të ndryshëm nga ato të kategorive D1 e D, masa maksimale e autorizuar e të cilëve i kalon 3500 kg, por jo më shumë se 7500 kg dhe të cilët janë projektuar dhe konstruktuar për transportin e jo më shumë se tetë pasagjerëve, përjashtuar drejtuesin e automjetit. Mjeteve të kësaj kategorie mund t'u lidhet një rimorkio, masa maksimale e autorizuar e së cilës nuk e kalon 750 kg;</li> <li>• Autokampe.</li> </ul>  | <p>19 vjeç</p> <p>Të paktën një vit pas B</p>  |
| C1E | <ul style="list-style-type: none"> <li>• Kombinimi i një mjeti motorik të kategorisë C1 dhe një rimorkioje ose gjysmërimorkioje, ku masa maksimale e autorizuar e rimorkios ose gjysmërimorkios është më shumë se 750 kg, por masa maksimale e autorizuar e kompleksit të formuar nuk i kalon 12000 kg;</li> <li>• Kombinimi i një mjeti të kategorisë B dhe një rimorkioje apo gjysmërimorkioje, masa e autorizuar e të cilave i kalon 3500 kg, me kusht që, në masë, kombinimi i autorizuar të mos i kalojë 12000 kg.</li> </ul> | <p>20 vjeç</p> <p>Të paktën një vit pas C1</p> |
| C   | <ul style="list-style-type: none"> <li>• Automjete të ndryshëm nga ato të kategorive D1 e D, masa maksimale e autorizuar e të cilëve i kalon 3500 kg dhe të projektuar e konstruktuar për transportin e jo më shumë se tetë pasagjerëve, përjashtuar drejtuesin e automjetit. Mjeteve të kësaj kategorie mund t'u lidhet një rimorkio, masa maksimale e autorizuar e së cilës nuk e kalon 750 kg.</li> </ul>   | <p>21 vjeç</p> <p>Të paktën 3 vjet pas B</p>   |
| CE  | <ul style="list-style-type: none"> <li>• Kombinimi i një mjeti të kategorisë C me një rimorkio ose gjysmërimorkio, ku masa maksimale e autorizuar e rimorkios ose gjysmërimorkios është më shumë se 750 kg.</li> </ul>   | <p>22 vjeç</p> <p>Të paktën një vit pas C</p>  |
| D1  | <ul style="list-style-type: none"> <li>• Automjet i projektuar dhe konstruktuar për jo më shumë se 16 pasagjerë, përjashtuar drejtuesin e automjetit, dhe me gjatësi maksimale që nuk i kalon 8 m. Mjetet e kësaj kategorie mund të tërheqin një rimorkio, masa maksimale e autorizuar e së cilës nuk i kalon 750 kg.</li> </ul>   | <p>22 vjeç</p> <p>Të paktën një vit pas C</p>  |
| D1E | <ul style="list-style-type: none"> <li>• Kombinimi i një mjeti të kategorisë D1 me një rimorkio ose gjysmërimorkio, ku masa maksimale e autorizuar e rimorkios ose gjysmërimorkios është më shumë se 750 kg.</li> </ul>  | <p>23 vjeç</p> <p>Të paktën një vit pas D1</p> |

|    |   |   |
|----|---|---|
| D  | <ul style="list-style-type: none"> <li>• Automjete të projektuar dhe konstruktuar për transportin e më shumë se tetë pasagjerëve, përjashtuar drejtuesin e automjetit. Mjeteve të kësaj kategorie mund t'u lidhet një rimorkio, masa maksimale e autorizuar e së cilës nuk i kalon 750 kg.</li> </ul> | <p>24 vjeç</p> <p>Të paktën 3 vjet pas C</p>  |
| DE | <ul style="list-style-type: none"> <li>• Kombinimi i një mjete të kategorisë D me një rimorkio ose gjysmërimorkio, ku masa maksimale e autorizuar e rimorkios është më shumë se 750 kg.</li> </ul>  | <p>25 vjeç</p> <p>Të paktën një vit pas D</p> |